



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 960/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllongjani kryesuese, Zyhdi Hajrizi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Berat Asllani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Vushtrri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.960/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Berat Asllani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Vushtrri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Berat Asllani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Vushtrria, me të cilën pretendon se në disa qendra të votimit ka pasur manipulim të votave duke u bazuar në formularët e skanuar në faqen e KQZ-se ka hasur në 10 vendvotime manipulim të votave ku kandidatët për kuvende komunale të një subjekti kanë më shumë vota se subjekti i njëjtë politik.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për manipulime të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e tij

janë vetëm supozime të imagjinuara dhe jo të konkretizuara në asnjë provë konkrete bindëse andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Berat Asllani nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Vushtri, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.960/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.